



Supriza me e kendeshme e javes se 9-te te Kategorise 1 ka qene fitorja ne transfertw e Himares ne Kamez. U duk se ndeshja ishte e lehte per kamzalinjte, por nga menyra se si u zhvillua loja, fitorja e himarjoteve ka qene mese e merituar. Poker i Dhramit i ka dhene skuadres himariote nje tre pikesh me vlere qe e largon gjithnje me shume nga fund i renditjes. Siutata ne kampionatin e kategorise se pare po paraqitet mjaft interesante dhe kjo jave nuk solli ndryshime te medha ne renditje. Kryesusesja aktuale, Elbasani, me nje gol te shenuar nga Pisha ne te 68', ruajti dhe kete jave vendin e pare. Te dytet jane pogradecaret qe me fitoren e arritur ndaj Dinamos, vazhdojne te ruajne te njeten distance pikesh( 3) me skuadren e vendit te pare. Ligenorete nuk e kishin te veshtire te permbysin golin e shenuar nga Turtulli ne te 14'. Loja e vendasve erdhi gjithnje ne rritje, qe solli edhe fitoren e ndeshjes. Nje nga takimet me te bukura te kesaj jave ka qene ajo e zhvilluar ne stadiumin e qytetit te Peqinit,ku Shkumbini vendas nuk mund te shkoje me shume se barazimi.Ish rivalet e kampionateve te superiors zhvilluan nje ndeshje te kenaqshme,duke merituar dhe duatrokitjete e sportdasheshve vendas. E pozicionuar ne vendin e katert ne renditje, duket se skuadra bardhekalter (peqinase) nuk eshte larg objektiveve per rikthimin sezonin e ardhshem ne kampionatin e me te mireve. Fillmisht jane miqte qe me ane te Shikos ne te 29' qe kalojne ne avantazh. Goli i miqve nuk ka zgjatur shume pa kunderpergjigje, pasi Branica ne te 36' ka barazuar rezultatin e ndeshjes. Nje tjeter ndeshje intresante dhe me shume grinte ishte ajo qe zhvillua ne qytetin e Gjirokastrës, midis Luftetarit e Butrintit. Derbi i jugut ka perfunduar me shifrat e barabarta 1-1 Miqte kane shenuar me ane te Mecanit ne te 68', por Nora per vendasit ka barazuar ne minuten e fundit, duke i mohuar miqve nje trepikesh te arte cka do t'i ngjiste dukshem ne renditje . Nje ndeshje e cila nga fillimi deri ne fund eshte karakterizuar nga lufta e forte sportive. Formacioni bluzinj e sheh vehten ne vendin e parafundit. Barazimi per te eshte ekuivalentja e humbjes. Formacioni jugor po rrezikohetr si asnjehere per te qene per te paren here ne historine saje qysh nga fillmi i themelimit te ketij klubi ne nje kategori me poshte (kategoria e dyte). Ndashjet e tjera dhane rezultate te pritshme. Pukjanet kane fituar ne fushen e tyre me rezultatin e ngushte 2-1. Golat e Agastres dhe dhe Shales kane sfumuar golin e avantazht te miqve te shenuar nga Kurti ne pjesen e pare. Ndersa Ada fale nje penalltie te fituar ne pjesen e pare,te shnderruar ne gol nga Mujesi, fiksoi nje fitore te rendesishme. Nje fitore e jetike per velipojaket qe marrin tre pikeshi e dyte ne kampionat. Ndashjet e javes se ardheshme do te zhvillohen pas nje jave ku ajo qe pritet me shume interes eshte takimi qe do te zhvillohet ne stadiumin e qytetit te Pogradecit, ku vendasit do te presin Apolonine e vendit te dyte e cila do te luaje te djelen mbasdate ne stadiumin e qytetit te Lushnjes si vendase dhe do te prese Mamurrasit.

## Kategoria 1/ Udhëheq Elbasani, surprizë e Himares ne Kamez

nga AlbaniaSoccer

E diel, 03 Nentor 2013 08:13

---

Rezultatet :

Pogradeci – Dinamo 3-1 Vangjo 17', Jahaj 77' , Cekici 90'/ Turtulli 14'

Kamza – Himara 1-6 Blloku 71/ Dhrami 41, 44' 47' 54' Muca 61' (autog), Kolgega 88' Elbasani - Albetrol 1-0 Pisha 68'

Terbuni – Velieci 2-1 Agasrta 46' , Shala 72' /Kurti 23'

Shkumbini - - Tomori 1-1 Branica 36' /Shiko 29'

Ada – Burreli 1-0 , Mujesi (11m ) 41'

Luftetari – Butrinti 1-1 Nora 90' / Mecani 68'

Apolonia – Mamurrasi luhet te dielen ne Lushnje